



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës Opština Podujevo Municipality of Podujeva
DREJTORIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Bazuar në nenin 62.3 të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, nenin 64 par.3 dhe 4 të statutit të Komunës nr.01-020/01-50862/18, nenin 18.3 të rregullores për kushtet/kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve nr.prot: 01-016/01-0030667/22 dhe bazuar në planin e punës dhe në buxhetin për vitin 2023, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural:

FTESË PUBLIKE
për aplikim në projektin:
FURNIZIMI DHE MONTIMI
I SERRAVE 300m²
(Vazhdim i implementimit të projektit)

Të drejtë aplikimi kanë:

- Banorë të Komunës së Podujevës

Dokumentet e nevojshme për të aplikuar janë:

- Kopjen e letërnjoftimit të aplikuesit
- Deklaratë/Çertifikatë e bashkësisë familjare
- Vërtetimin e Tatimit në pronë (dëshmi për pagesën e tatimit)
- Çertifikata mbi pronësinë e tokës dhe skica e planit, ndërsa në mungesë të saj kontrata mbi marrjen me qira të tokës me kohëzgjatjen deri në 3 vite
- Çertifikata e regjistrimit të fermerit (NIF-i)

Forma e vlerësimit:

Kriteret	Poena
1 Familjet (aplikuesit) pa asnjë anëtar të punësuar (Dokument zyrtar i cili dëshmon)	10
2 Aplikuesit me përgatitje profesionale shkollore (Fakulteti i Bujqësisë, Student)	10
3 Familjet me numër më të madh të anëtarëve (për çdo anëtar 5 poena)	
4 Aplikues/e (familjet) që nuk kanë përfutur më parë nga ndonjë projekt, thirrje apo ftesë publike të Komunës në 3 vitet e fundit.	10

VËREJTJE:

- Përfutuesit do të marrin pjesë me 30% të vlerës së projektit.
- Personi fizik apo juridik vetëm një herë në vit mund të jetë përfutues i subvencioneve të ndara nga komuna. (neni 6.2 i rregullores së subvencioneve)
- Aplikimi fillon me datë 25.07.2023 dhe mbaron 21.08.2023.
- Aplikacionet me dokumentacion të pakompletuar dhe të dorëzuara pas afateve kohore nuk do të merren parasysh.
- Përparësi kanë aplikuesit të cilët nuk kanë përfutur ndonjë projekt nga Komuna.



Drejtori i BPZHR: **Z. Vigan Salihu**

Nr. prot. 12-060/03-0052812/23